

Parashtrim i Situatës: Vlerësim i gjendjes dhe ndjeshmërive të Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në përballjen e tyre me COVID-19¹

Një Goditje e Paprecedentë

Në Pranverë 2020, vendet e Ballkanit Perëndimor —ashtu si shumë vende të tjera në botë—u detyruan të vendosin masa të forta kufizuese në jetën ekonomike për të frenuar përhapjen e pandemisë COVID-19. Në gjysmën e parë të 2020-s, bota përjetoi rritje shpërthyesë të infektimit nga virusi i ri vdekjeprurës. Pandemia nuk kurseu as vendet e Ballkanit Perëndimor, ku shumë vende u detyruan të mbyllin njëra pas tjetrës shumë aktivitete sociale dhe ekonomike me qëllim ngadalësimin e përhapjes së infektimit. Rastet e para u shënuan që në javën e parë të Marsit. Sipas të dhënave të qendrës për koronavirusin në Universitetin Johns Hopkins, numri i rasteve të konfirmuara në të gjashtë vendet e rajonit deri në 24 Prill, 2020 është rreth 11,000. Të gjashtë vendet kanë reaguar duke imponuar izolim në shtëpi dhe masa të rrepta të distancimit social. Aeroportet ndërkombëtare në të gjitha vendet u mbyllën për trafikun e pasagjerëve. Periudhat fillestare të izolimit u zgjatën. Kryeqytetet e Kosovës dhe Shqipërisë janë në karantine, ashtu siç janë dhe qytete të tjera të rajonit. Aktivitete kyçe të ekonomisë, si restorantet dhe tregtia me pakicë e artikujve jo jetik, u mbyllën. Gjithashtu, janë mbyllur shkollat dhe universitetet, si dhe janë kufizuar ose ndaluar udhëtimet dhe grumbullimet e njerëzve.

Kriza e COVID-19 ka pasojë të rënda për ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor, pasi oferta agregate dhe kërkesa agregate po tkurren njëkohësisht. Jo vetëm kufizimet e qeverisë, por edhe reagimi i familjeve dhe bizneseve ndaj krizës po ushtrorjnë presion të paprecedentë në ekonomitë e rajonit. Rënia e aktivitetit ekonomik ka sjellë gjithashtu probleme për financat publike dhe ka rritur nevojën për financim të qeverive.

Kërkesa agregate në kolaps. Konsumatorët shmangin aktivitetet që mund t'i ekspozojnë ato ndaj infeksionit. Sezoni turistik veror pritet të jetë i dobët. Investimet dhe konsumi jo jetik janë shtyrë deri në zgjidhje të pasigurisë lidhur me krizën. Probleme të ngjashme në partnerët kryesorë tregtarë, siç është BE-ja, do të rëndojnë mbi eksportet.

Edhe oferta agregate po tkurret. Kufizimet e vendosura nga qeveritë i detyrojnë bizneset dhe kompanitë me aktivitet jo jetik, të cilat nuk mund të plotësojnë kushtet për distancim social, të qëndrojnë mbyllur ose të zvogëlojnë veprimtarinë me qëllim parandalimin e shpërthimit të pandemisë. Ndonëse disa biznese mund të vijojnë aktivitetin përmes shitjes ose punës online, shumica e tyre do të përjetojë rënie të produktivitetit. Një pjesë e punonjësve duhet të qëndrojnë në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët për shkak të mbylljes së shkollave ose sepse duhet të zbatojnë distancimin social për të shmangur infektimin. Ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit vendas dhe ndërkombëtar dëmtojnë aktivitetin prodhues. Rënia e çmimeve të mallrave ndikon në zvogëlim të marzheve të fitimit në industrinë nxjerrëse. Kufizimet e likuiditetit mund të shkaktojnë ndërprerje të mëtejshme në prodhim.

Spektori më i goditur pritet të jetë ai i shërbimeve, veçanërisht ato që kërkojnë ndërveprim fizik. Kufizimet e qeverisë kanë detyruar mbylljen e pjesës më të madhe të shërbimeve të mikpritjes, tregtisë me pakicë dhe atyre që kërkojnë prezencë fizike. Kufizimet e vendosura në transportin e udhëtarëve të cilat synojnë të shmangin kontaktet e afërta midis udhëtarëve, si në autobusë, trena dhe aeroplanë, e

¹ Ky shënim i RRE i paraprin diskutimit të detajuar në shënimin shoqëruar të RRE të titulluar "Perspektiva e Ballkanit Perëndimor: Kohët e Vështira Kërkojnë Ekonomizim të Mirë".

kanë dëmtuar rëndë këtë sektor. Pothuajse për të njëjtat arsye edhe turizmi është në kolaps; edhe pasi kriza të jetë vënë nën kontroll, do të duhet kohë që turizmi të rigjallërohet. Nga ana tjetër, industria prodhuese po vuan për shkak të masave mbrojtëse të distancimit social të cilat shkaktojnë pengesa në prodhim, rënie të porosive dhe probleme në zinxhirin e furnizimit. Relativisht më të fortë janë sektorët thelbësorë si mjekësia, zinxhiri i furnizimit me ushqime, sektori publik si dhe sektorët ku mund të punohet online, siç janë shërbimet profesionale të lidhura me ekonominë dixhitale.

Kjo krizë është ndryshe:

1. Kjo është një goditje për sistemin shëndetësor në tërësi, që kërkon ngrirjen e përkohshme, të ndërjegjshme dhe të nevojshme të aktivitetit me qëllim ngadalësimin e përhapjes së virusit. Kohëzgjatja dhe thellësia e krizës do të varet nga efikasiteti i masave kufizuese, aftësia e sistemit shëndetësor për të përballuar shpërthimin e pandemisë, si dhe nga suksesi në zhvillimin e trajtimeve efikase dhe vaksinave për sëmundjen.
2. Politikat ekonomike në vetvete nuk janë të mjaftueshme për t'i dhënë fund krizës, por ato luajnë rol thelbësor: mbrojnë mjetet e jetesës duke ruajtur vendet e punës dhe forcuar rrjetin e sigurisë sociale.
3. Një rikuperim i shpejtë ekonomik është i mundshëm, por jo i sigurt. Lehtësimi i masave të izolimit mund të zhbllokojë konsumin dhe investimet e lëna pezull, të cilat do të inkurajonin rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik. Por goditja mund të ketë dëmtuar rëndë produktivitetin në periudhë afatmesme, duke qenë se ngrirja e aktivitetit ekonomik dhe mungesa e likuiditetit detyron mbylljen e bizneseve të konsoliduara, prishjen e marrëdhënieve produktive në zinxhirin e furnizimit, ose largimin e punonjësve me njohuri të konsiderueshme në proceset e punës. Nëse kriza do të gërryente burimet e amortizatorëve financiarë publik dhe privat, përpjekjet për të konsoliduar dhe rivendosur bilancet mund të rëndojnë mbi rikuperimin ekonomik. Në rast se kërcënimi nga virusi do të zgjaste në kohë, atëherë shqetësimet lidhur me përsëritjen e epidemisë dhe masat kufizuese do të linin në hije rikuperimin ekonomik.

Me qëllim zbutjen e efekteve të krizës, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë njoftuar paketa të konsiderueshme fiskale që variojnë nga 1 deri në 7 përqind të PBB-së (pa përfshirë garancitë) për të mbështetur qytetarët dhe bizneset.²

Sa të përgatitura ishin vendet e Ballkanit Perëndimor për një krizë madhore?

Pasiguritë në rritje për perspektivën e rajonit janë evidentuar që në *Raportin e Rregullt Ekonomik të Vjeshtës 2019*, sepse edhe para krizës së COVID-19, pritej që ritmet e rritjes ekonomike të ngadalësoheshin si në rang global ashtu edhe në Zonën Euro. Eurozona, ku gjenden edhe partnerët kryesorë tregtarë të Ballkanit Perëndimor, pritej të ngadalësohej në 1.0 përqind.³ Edhe çmimet e metaleve bazë, të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të eksporteve të mallrave rajonalë, parashikohej të pësonin rënie. Rreziqet e brendshme ishin rritur si rezultat i rrethanave politike: Disa vende kanë planifikuar zhvillimin e zgjedhjeve. Në Kosovë, zgjedhjet parlamentare u mbajtën në 6 Tetor ndërsa në Shkurt 2020 u formua qeveria— e cila u rrëzua më 25 Mars me mocion mosbesimi dhe aktualisht funksionon si qeveri kujdestare. Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia e Veriut kanë planifikuar zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare ndërsa Bosnje-Hercegovina ka planifikuar zgjedhjet lokale. Për më


² Shiko shënimin shoqëruar të RReE “Perspektiva e Ballkanit Perëndimor: Kohët e Vështira Kërkojnë Ekonomizim të Mirë”.

³ Perspektiva e Ekonomisë Globale, Janar 2020

teper, Shqipëria u godit nga një tërmet i fuqishëm në Nëntor 2019, i cili rriti nevojën për financim të ri e të madh për rindërtim.

Modeli i rritjes ekonomike të Ballkanit Perëndimor ishte i brishtë edhe përpara fillimit të krizës. Konsumi përbënte më shumë se 60 përqind të rritjes ekonomike në vitet e fundit në rajon (Figura 1). Rritja e konsumit në disa vende erdhi si rezultat i rritjes së shpenzimeve publike, politikave të veçanta të pagave si dhe rritjes gati dyshifrore në huamarrjen e familjeve, duke ngritur kështu pikëpyetje mbi qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike në rajon të mbështetur nga konsumi. Kontributi i investimeve ishte rreth 47 përqind në 2019-n ndërsa eksportet neto kontribuan negativisht. Shqipëria, Bosnje-Hercegovina dhe Kosova shënuan rritje të dobët të investimeve gjatë 2019-s ndërsa konsumi u rrit fuqishëm si rezultat i rritjes së fluksit të remitancave dhe kredive konsumatore. Rritja ekonomike e Malit të Zi u nxit kryesisht nga realizimi i një investimi madhor publik. Eksportet neto ngadalësuan ritmet e rritjen ekonomike të rajonit gjatë 2019-s: ato kanë patur mesatarisht kontribut negativ në rritje gjatë periudhës 2012–18, për shkak të nivelit të lartë të importeve, numrit të ulët të eksportuesve konkurrues, dhe dobësimit ekonomik të partnerëve kryesorë tregtarë të rajonit, në mënyrë të veçantë të vendeve të BE-së. Produktiviteti, përfshirë rritjen e prodhimit dhe shërbimeve të avancuara, ka mbetur mbrapa për sa i përket përpjekjeve që duhet të bëjë rajoni për të arritur nivelin e të ardhurave në vendet e përparuara të BE-së.

Figura 1. Rritja ekonomike para krizës në Ballkanin Perëndimor u ngadalësua nga ritmet e ulëta të investimeve dhe eksportet neto.



Përballja me krizën e COVID-19 ka nxjerrë në pah ndryshimet midis pikave të forta dhe të dobëta të ekonomive të Ballkanit Perëndimor. Një hartë të dhënash (Figura A.1) është një mënyrë e dobishme për ta përmbledhur këtë, veçanërisht nëse plotësohet me një analizë të detajuar cilësore sipas vendeve. Gjithashtu me vlerë do të ishte kryerja e një vlerësimi shumë-dimensional që analizon karakteristikat e tregjeve rajonale të punës, përbërjen sektoriale të secilës ekonomi, hapësirën e politikës fiskale, hapësirën e politikës monetare, amortizatorët financiarë dhe dobësitë e jashtme.⁴

Së pari, tregjet e punës të cilat karakterizohen nga nivele disproporcionale të punësimit informal, të përkohshëm dhe vetë-punësimit, ka të ngjarë të përballen me shkatërrim të vendeve të punës, gjë që

⁴ Më poshtë trajtohet shkurtimisht gjendja dhe ndjeshmëritë e ekonomive të Ballkanit Perëndimor në secilën prej këtyre fushave. Një diskutim i hollësishëm i ndikimit të COVID-19 në fusha specifike ekonomike, sektorët socialë dhe ndikimet sociale në rajon do të jepet në shënime të veçanta të RrE që do të publikohen në vijim të prezantimit elektronik.

do të shkaktojë vështirësi të konsiderueshme, veçanërisht në ato raste kur rrjeti i sigurisë shoqërore nuk është mjaftueshëm i fortë. Norma e punësimit në Ballkanin Perëndimor arriti në 44.3 përqind në fund të 2019-s, duke pësuar rritje nga 42.7 përqind në 2018-n dhe 36.9 përqind në 2012-n. Megjithatë, pjesa më e madhe e vendeve të punës kishin intensitet të lartë pune dhe pagë të ulët dhe ishin në industrinë prodhuese dhe sektorin e shërbimeve. Normat e ulëta të punësimit dhe nivelet e larta të papunësisë kanë ndikuar ndjeshëm në frenimin e rritjes gjithëpërfshirëse në Ballkanin Perëndimor. Shumica e vendeve të punës janë të përkohshme ose informale. Me përhapjen e krizës së COVID-19, ka gjasa që këto vende pune të shkatërrohen duke përmbysur kështu arritjet e viteve të fundit në këtë drejtim. Ç'është më e keqja, shumë prej këtyre punëtorëve mund të mos kenë akses në rrjetat e sigurisë shoqërore. Siç vihet re edhe nga diagrami (Figura A.1), këto probleme janë veçanërisht të mprehta në Kosovë (ku punësimi është i ulët dhe kryesisht i përkohshëm), Bosnje-Hercegovinë (nivel i ulët punësimi dhe shkallë e lartë informaliteti), dhe Shqipëri (nivel i lartë vetë-punësimi dhe punësimi informal).

Së dyti, rëndësia që ka sektori i turizmit për ekonomitë e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kosovës, i bën këto vende më të ndjeshme ndaj ndikimit ekonomik të krizës krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Struktura e ekonomive të Ballkanit Perëndimor kontribuon në shtimin e dobësive të tyre. Së jashtmi, ekonomitë e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kosovës varen në shkallë të lartë nga eksportet e shërbimeve, kryesisht turizmi; baza e eksportit të mallrave është shumë e ngushtë (shiko Fig. A.1). Për pasojë, shpërthimi i COVID-19 mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomitë e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kosovës për shkak të kufizimeve në transportin e udhëtarëve, por edhe për shkak të ndryshimeve në sjelljen konsumatore pas pandemisë. Turizmi i Kosovës mund të rezultojë më i qëndrueshëm: ai mbështetet kryesisht tek turistët e diasporës. Për sa i përket Bosnje-Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, eksportet e mallrave përbëjnë një përqindje më të lartë të PBB-së; pra ata janë të lidhur më mirë me zinxhirët e vlerës në rang global si rrjedhojë e industrive të shëndetshme të prodhimit të automobilave dhe pjesëve të këmbimit. Këto ekonomi do të preken nga ndërprerja e zinxhirëve të vlerës në rang global si dhe rënia e kërkesës për mallra të qëndrueshëm.⁵ Shitja me pakicë, mikpritja dhe argëtimi përbëjnë më shumë se 10 përqind të punësimit në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe shumica e këtyre bizneseve u detyruan të mbyllen për shkak të epidemisë.


Së treti, mbështetja e politikës fiskale është thelbësore për të ndihmuar sektorin privat për të përballuar krizën, por vendet e rajonit nuk kanë hapësirë të mjaftueshme fiskale për masa të reja (Figura A.1). Ndonëse në nivele relativisht të ulëta, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Malit të Zi, kishin deficite fiskale në 2019-n (Figura 2). Sidoqoftë, pavarësisht performancës relativisht të mirë gjatë viteve të fundit në mbledhjen e të ardhurave, fakti që të ardhurat në rajon ndjekin ato në Eurozonë gjithashtu kufizon hapësirën fiskale për reagim ndaj krizave krahasuar me ekonomitë e përparuara. Kjo është veçanërisht e vërtetë për Kosovën dhe Shqipërinë. Me përjashtim të Kosovës dhe Bosnje-Hercegovinës, borxhi publik në vendet e vijon të jetë në nivele të larta që prej krizës globale financiare dhe krizës në Eurozonë (Figura 3); por të dyja këto vende e kanë të vështirë të sigurojnë akses në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, kështu që burimet e tyre të vetme të financimit mbeten institucionet financiare ndërkombëtare (IFI). Megjithëse ekziston hapësira për thellimin e deficiteve gjatë krizës së COVID-19, e cila duhet të përdoret krahas aktivizimit të masave mbështetëse të politikës ekonomike, pritjet që politika fiskale të frenohet nga shqetësimet për mbajtjen e borxhit nën kontroll dhe sigurimin e financimit nga tregjet dhe kreditorët zyrtarë. Për më tepër, pritjet që

⁵ Modeli i kërkesës për mallra të qëndrueshëm është i ngjashëm me atë të investimeve; të dy kanë tendencë të jenë shumë ciklike, duke u tkurrur gjatë rënieve ekonomike (Bils dhe Klenow 1998, Caramp, Colino dhe Restrepo 2017).

stabilizatorët automatikë të jenë të pakët për shkak të numrit të kufizuar në rajon të instrumentave të mbrojtjes sociale, si pagesa e papunësisë dhe shpenzimet e mbrojtjes sociale.

Së katërti, vendet e rajonit nuk kanë shumë alternativa zgjedhjeje për sa i përket politikave monetare, veçanërisht Kosova dhe Mali i Zi, të cilat adoptuan euroizim të njëanshëm. Edhe Bosnje-Hercegovina ka numër të kufizuar të instrumentave për politika aktive monetare për shkak të marrëveshjes së bordit të monedhës. Në vendet e tjera, normat e ulëta të interesit para krizës ngushtojnë hapësirën për lehtësim konvencional të politikave monetare. Ndërkohë, niveli i lartë i euroizimit përbën rrezik për stabilitetin financiar të atyre vendeve ku bankat janë të ekspozuara ndaj rreziqeve indirekte të kreditimit përmes ekspozimit ndaj huamarrësve të pambrojtur dhe rritjes së mundshme të kërkesës për instrumente të këmbimit valutor (FX). Me largimin e kapitalit ndërkombëtar gjatë krizës nga tregjet në zhvillim, vendet me kurse fleksibël të këmbimit po shohin zhvlerësim të monedhave të tyre. Por duke pasur parasysh ngrirjen e përgjithshme të ekonomisë globale, përfitimet nga konkurrueshmëria e çmimeve nuk ofrojnë mbështetje të mjaftueshme, dhe bankat qendrore po ndërhyjnë për të stabilizuar kurset e tyre të këmbimit. Për shembull, Banka Kombëtare e Serbisë ka arritur të sigurojë likuiditet për sistemin bankar duke ulur normën bazë të interesit dhe nëpërmjet operacioneve sëap dhe repo të FX.

Së pesti, sektorët financiar disponojnë përgjithësisht amortizues të fortë të kapitalit dhe likuiditetit – megjithëse ato do të vihen në provë gjatë kësaj shtate. Sistemet financiare janë më fleksibël se më parë, pjesërisht për shkak të reformave të ndërmarra në sektorin financiar pas krizës financiare globale të 2008-09. Sistemet bankare të Ballkanit Perëndimor hyjnë në këtë krizë me amortizues të fortë agregat të kapitalit dhe likuiditetit. Në Shqipëri, bashkimet e bankave dhe heqjet e licencave kanë forcuar sistemin përmes konsolidimit. Në Mal të Zi, dy banka me kapitalizim të pamjaftueshëm i janë nënshtruar procesit të likuidimit. Në Kosovë, futja e agjentëve privat të përmbartimit dhe nxjerrja jashtë bilancit të kredive me probleme ka cuar në uljen e tyre, duke shënuar nivelin më të ulët historik prej 2 përqind ndaj totalit të kredive në fund të 2019-s. Megjithatë, pavarësisht se kreditë me probleme kanë shënuar rënie në të gjitha vendet, ato mbeten ende në nivele të larta në Shqipëri dhe BH, ndërsa vijojnë të ekzistojnë shqetësimet lidhur me qëndrueshmërinë e bankave individuale private dhe shtetërore. Ndonëse niveli i kredive para krizës pësoi rritje në pjesën më të madhe të rajonit, ka gjasa që ngrirja ekonomike të vërë në provë sistemin. Shumë huamarrës aktualë do të përballen me kufizime të likuiditetit dhe mund të ndërpresin pagesat e kësteve të kredive, dhe në këto kohë të vështira për ekonominë ka të ngjarë që bankat të bëhen jashtëzakonisht të kujdesshme në lidhje me dhënie e kredive të reja. Prandaj do të jetë me rëndësi shfrytëzimi i mekanizmave të tillë si fondet e garantimit të pjesëshëm të kredive, subvencionet e eksportit dhe kreditë e subvencionuara nga bankat e zhvillimit me qëllim zvogëlimin e sfidave të likuiditetit të kompanive me aftësi paguese. Kriza kërkon një monitorim dhe mbikëqyrje të ngushtë të sektorit financiar me qëllim minimizimin e rreziqeve të mundshme që mund të vijnë nga kriza - politikë-bërësit duhet të jenë të gatshëm të ndërhyjnë në kohë sipas nevojës. Megjithëse gjatë dekadës së fundit janë bërë përmirësime të dukshme, ka ende disa mangësi në mbikëqyrjen bankare në drejtim të menaxhimit të krizave, zgjidhjes dhe falimentimit të cilave duhet t'u jepet zgjidhje.



Së gjashti, përgjatë krizës do të jetë e nevojshme financimi i deficiteve të larta të llogarisë korrente, veçanërisht në Mal të Zi dhe në një masë më të vogël në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi (Figura A.1). Deficitet tregtare në Ballkanin Perëndimor arritën në 13.8 përqind të PBB-së në 2019-n. Eksportet kryesore ishin në sektorin e turizmit ndërkombëtar, industrinë përpunuese dhe atë nxjerrëse –të gjitha të prekura nga kriza e koronavirusit. Në të kaluarën, deficitet tregtare financoheshin kryesisht nga remitancat dhe investimet e huaja direkte (IHD-të), të cilat janë tkurrur ndjeshëm gjatë kësaj krize. Ndërsa remitancat priren të jenë më fleksibël në kohë krizash, kjo gjë mund të mos jetë e vërtetë këtë herë, pjesërisht për shkak se një pjesë e madhe e tyre vijnë përmes kanaleve informale, por edhe sepse shumë njerëz në diasporë mund të kenë humbur vendet e punës si pasojë e masave kufizuese për parandalimin e virusit. Ka të ngjarë që të ketë vonesa në flukset aktuale dhe të reja të IHD-ve pasi kriza ka shkakuar ngrirjen e një pjese të madhe të jetës ekonomike në Ballkanin Perëndimor dhe pasiguria ekonomike nuk është zgjidhur. Rezervat valutore do të luajnë rol vendimtar në financimin e disbalancave të jashtme gjatë krizës.

Përhapja e krizës së COVID-19 do të shërbejë si një test për ekonominë e Ballkanit Perëndimor. Ngrirja e ekonomisë do të rrisë presionin mbi buxhetet e qeverive dhe bilancet e sektorit privat. Familjet do të humbasin vendet e punës, ndërsa disa biznese dikur fitimprurëse do të mbyllën. Për më tepër, do të duhet një menaxhim i kujdesshëm i likuiditetit në të gjithë sektorët ekonomikë, me qëllim shmangjen e përshkallëzimit të krizës. Në këto kohëra të vështira, politikat publike duhet të bëjnë gjithçka për lehtësimin e gjendjes së rëndë ekonomike, përmes planifikimit të masave për t'u ardhur menjëherë në ndihmë atyre që kanë më shumë nevojë. Sa më shumë të zgjasë ngrirja ekonomike, aq më të rënda do të jenë pasojat në ekonomi nga kjo krizë e shëndetit publik si rezultat i përdorimit të amortizatorëve të kapitalit dhe likuiditetit në të gjithë sektorët e ekonomisë. Këto kohë do të shërbejnë si test për qëndrueshmërinë e ekonomive të Ballkanit Perëndimor - dhe vendosmërinë e qytetarëve të tyre për të përballuar dhe fituar luftën kundër COVID-19.

Vendet duhet të shfrytëzojnë të gjitha opsionet e mundshme për menaxhimin e krizës, duke përfutur nga asistenca e ofruar, sic është aksesimi në financim përmes Institucioneve Financiare Ndërkombëtare. Në rast se ka hapësirë për politika fiskale dhe monetare, kjo është koha e duhur për ta përdorur atë me qëllim ruajtjen e kapacitetit prodhues të ekonomive dhe funksionimin e tregjeve si dhe për të mbështetur dhe shpëtuar jetët e njerëzve dhe mjetet e jetesës. Për shkak të burimeve të kufizuara,

mbështetja përmes politikave duhet të jetë e shpejtë, e përcaktuar në kohë, e targetuar dhe transparente. Me daljen nga kriza, vendet e rajonit duhet të zhvendosin fokusin e politikave të tyre nga lufta kundër COVID-19 në rifillimin e ekonomisë – e si rrjedhim në normalizimin e bilanceve dhe uljen e borxhit të akumuluar gjatë krizës.

Figura A.1. Hartë e të Dhënave për Ndjeshmërinë Relative ndaj COVID-19 të Ballkanit Perëndimor

		Shqipëria	BH	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
1. Tregu i Punës	Të vetëpunësuar (% e totalit të të punësuarve)	34.7	17.6	21.3	19.4	14.3	22.4
	Punësim i përkohëshëm (% e totalit të të punësuarve)	9.7	17.5	79.5	34.6	16.1	22.6
	Punësim informal (% e totalit të të punësuarve)	61	29.5		19.9		19.8
	Shkalla e punësimit (% popullsisë mbi 15 vjeç)	52	34.3	25.4	48.1	44.9	48.6
2. Politika fiskale	Bilanci fiskal (% e PBB-së)	-2.5	-0.5	-2.5	-3.0	-2.1	-0.2
	Të ardhura (% e PBB-së)	27.8	42.6	26.7	43.6	31.2	42.1
	Borxhi PPG (% e PBB-së)	68.0	34.6	17.6	80.7	48.9	52.9
3. Hapësira e politikës monetare	Kursi i Këmbimit (1-fleksibël, 0-fiks)	1	0	0	0	1	1
4. Politika e sektorit financiar	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	18.3	18.1	15.9	17.7	16.3	23.4
	Norma e likuiditetit (asetet likuide si % e totalit të asetëve)	35.7	29.6	28.9	20.8	24.0	36.0
	Kreditë me probleme (% e totalit të kredive)	8.4	7.4	2.0	5.1	4.6	4.1
5. Dobësi të jashtme	Llogaria korrente (% e PBB-së)	-7.6	-3.7	-5.5	-15.2	-2.8	-6.9
	Eksporti i mallrave (% e PBB-së)	6.8	29.0	5.6	9.5	47.0	35.8
	Eksporti i shërbimeve (% e PBB-së)	23.9	10.8	23.2	34.6	14.7	14.0
	Turizmi ndërkombëtar (% e eksporteve)	48.2	12.7		50.8	5.1	7.7
	Eksportet e udhëtimeve/transportit (% e eksportit të shërbimeve)	60.7	44.8	82.5	85.5	20.9	33.5
	Fluksi hyrës i remitancave (% e PBB-së)	5.2	8.4	12.0	4.0	1.7	5.8
	Rezervat (në muaj të importeve)	6.4	7.8	2.3	6.3	3.8	5.7
<p><i>Burimet:</i> ILO, UNCTAD, ëDI, autyoritetet kombëtare (të dhënat më të fundit të disponueshme më 22 Prill, 2020). <i>Shënim:</i> Treguesit e përzgjedhur në sektorin real, sektorin financiar, sektorin e jashtëm, politikën fiskale dhe politikën monetare paraqesin vetëm një pamje të kufizuar të një game të gjerë faktorësh që shoqërohen me rreziqe makroekonomike dhe dobësi. Kodimi i ngjyrave bazohet në vlerat e treguesit në lidhje me njëri-tjetrin dhe duhet të shihet rreptësisht brenda kontekstit të diskutimit në këtë shënim. <i>Shënim:</i> Remitancat e punëtorëve që hyjnë në Maqedoninë e Veriut përmes kanaleve zyrtare arritën 1.6 përqind të PBB-së në vitin 2019. Sidoqoftë, në total transfertat private ishin 13.6 përqind e PBB-së në 2019.</p>							